

**STATUT AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"AUTOBLUE" Sh.p.k**

Mbeshtetur ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregtare", ne ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 "Per QKR", sot me date 22 Maj 2024 me vullnetin e lire e te plote vendosem te krijojme dhe miratojme statutin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "AUTOBLUE" sh.p.k, me kete permbajtje,

**I.-DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Sot me date 27.05.2024 ne, themeluesit, ne mbeshtetje te legjistacionit Shqiptar, kryesisht ne ligjin nr.9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare", i ndryshuar dhe akteve te tjera ligjore ne fuqi, ka perpiluar dhe nenshkruar statutin e Shoqerise si me poshte vijon :

**Neni 1-Forma**

Shoqeria "**Autoblue**" sh.p.k eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, veprimtaria e se ciles do te rregullohet me ane te ketij Statuti dhe nga legjistacioni ne fuqi.

Ky statut eshte perpiluar ne perputhje me legjistacionin shqiptare dhe ka karakter te detyrueshem per nenshkruarit e tij, çeshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne te, plotesohen nga legjistacioni shqiptare.

Shoqeria me pergjegjesi te Kufizuar "**Autoblue**" Sh.p.k, krijohet nga ortaket

- **Besjan Shahini**, i identifikuar me Karte Identiteti nr.J51008021J, i biri Enver, i datelindjes 08.10.1995,Lindur ne Gramsh, banues ne adresen ;Rruga Kavajes,Ndertesha nr.63,Hyrja1,Njesia bashkiake nr.7,Zona kad.1023,Tirane.

**Neni 2 – Emertimi**

Emertimi i shoqerise eshte "**Autoblue**" Sh.p.k.

**Neni 3 – Selia**

- Shoqeria "**Autoblue**" sh.p.k, me seli ne adresen: Rruga "Ndre Mjeda", Z.K 8220, Kompleksi Kontakt , Njesia Bashkiake nr.7, Z.K 8220, Nr. Pasurie 3/491+5-N9, Tirane

**Neni 4**

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete mbi 10(dhjete) vjet. Ky afat mund te zgjatet me vendim te ortakeve te saj themelues ne pajtim me legjislacionin ne fuqi.

**II.-OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

**Neni 5**


Objekti kryesor i veprimtarise se Shoqerise "**Autoblue**" sh.p.k, do te jete : Tregtim i automjeteve te reja dhe te perdorura te te gjitha llojeve,tregtim i pjeseve te kembimit, vajrave industrial per mjetet motorrike, goma, bateri, antifrizet, solucione te ndryshme dhe te tjera te ngjashme.Import-Eksport. Shoqeria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

**Neni 6**

Shoqeria ka te drejte te shtoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te Ortakeve te saj.

**Neni 7**

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Ajo mund te krijojte filial, dege e perfaqesi brenda e jashte vendit ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendeve ku do te ushtroje veprimtarine.



#### Neni 8

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj per te realizuar fitimin duke u mbeshtetur ne parimet e likujditetit. Per detyrimet e veta Shoqeria pergjigjet me pasurine e saj.

### III-MJETET E SHOQERISE

#### Neni 9

Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte ne vleren **100 000 (Njeqindemije) Leke**. Kapitali i shoqerise eshte ndare ne nje kuote sipas pjesemarrjes ne pergjindje per secilin ortak. Kapitali themeltar i shoqerise zoterohet si me poshte :

- **Z. Besjan Shahini**, Me cilesine e ortakut themelues zoteron nje kuote e barabart me 100 % te vlerse se aksjoneve te shoqerise 100 000 leke (njeqindemije).

#### Neni 10

Kapitali i Shoqerise mund te shtohet me vendim te ortakeve te saj, vendim i cili duhet te depozitohet ne zyren perkatese. Aktiviteti ne kete shoqeri nuk i pengon ortaket te kene te drejta pronesie dhe aktivitet jashte kesaj shoqerie.

### IV.-ADMINISTRIMI I SHOQERISE

#### Neni 11

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj duke u bazuar ne kete Statut dhe ne ligjet ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

#### Neni 12

Shoqeria kryen veprimtarine e vet me mjetet e saj financiare, me mjete e kredi te akorduara ne menyre te ligjshme. Ajo eshte e detyruar qe vellimin e punes se vet ta ushtroje ne vartesi te shumes se mjeteve te investuara dhe te shumes se mjeteve te rezervuara.

#### Neni 13

Shoqeria gezon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka te drejte ti perdore ato ne perputhje me objektin dhe qellimin e veprimtarise se saj.

#### Neni 14

Kapitali themeltar i shoqerise dhe kapitali i mevonshem mund te krijoje nje fond te vecante , qe mund te mbetet ne llogarine bankare te shoqerise. Fondet monetare te shoqerise do te perdoren ne perputhje me kete statut te shoqerise dhe ligjet ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

#### Neni 15

Shoqeria do te çeli llogari ne banke. Ajo do te mbaje llogarine duke u mbeshtetur ne lekun shqiptar, ne euro, usd e monedha te tjera te huaja. Veprimet bankare do te kryhen nga ana e ortakeve dhe administratoret e saj.

#### Neni 16

Shoqeria do te krijoje keto fonde: Fondi Themeltar, Fondi Rezerve , Fondi i Shperblimit. Per zhvillimin e veprimtarise se vet shoqeria mund te krijoje edhe fonde te tjera. Fondi themeltar i shoqerise formohet nga Kapitali Themeltar si dhe mjetet qe do krijohen gjate aktivitetit ekonomik te saj.

#### Neni 17

Shoqeria shfrytezon fondin Themeltar per ushtrimin e veprimtarise se vet per investime te ndryshme ne interes te realizimit te qellimit te shoqerise, si dhe per te mbuluar rreziket mbas shfrytezimit te fondit rezerve. Fondin Themeltar shoqeria mund ta shfrytezoje edhe per destinacione te tjera te veprimtarise se saj afariste.

#### Neni 18

Fondi Rezerve i shoqerise formohet nga nje pjese e fitimit, qe ajo realizon gjate veprimtarise se saj, qe percaktohet me nje vendim te vecante te Ortakeve te saj. Fondi Rezerve shfrytezohet per te mbuluar humbjet dhe rreziket.



## V.-ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

### Neni 19

Organet drejtuese te shoqerise:  
-Ortaket e shoqerise .

- -Administratori i shoqerise do te jete **Zj.Klevisa Hafesllari** , per nje afat 5 (pese) vjet,Me adrese banimi; Rruga Kavajes,Ndertesa nr.63,Hyrja 1,Njesia bashkiake nr.7,Zona kad.1023,Tirane.

### Neni 20

*Ortaket e shoqerise ushtrojne keto funksione* : Nxjerr planin dhe programin e zhvillimit te veprimtarise se shoqerise dhe aktet e pergjithshme, vendime per ndryshimin e emertimit te shoqerise, te cilesise se saj, te objektit te veprimtarise, per shtim ortakesh , ndryshim administrator. Vendos per rritjen ose pakesimin e kapitalit themeltar te shoqerise,miraton bilancin vjetor dhe raportin financiar te shoqerise, vendos per ndryshimin e forms se organizimit te shoqerise. Vendos per mbylljen e veprimtarise dhe caktimin e likujdatoreve.Te gjitha keto funksione do te kryhen ne perputhje me ligjin "Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit "Per regjistrin tregtar".

### Neni 21

*Administratori i shoqerise ka keto detyra:*

Organizimin e drejtimin e punes dhe veprimtarise se shoqerise,perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me te tretet. Mban pergjegjesi per zbatimin e ligjeve ne shoqeri si dhe per aktivitetin ekonomik te saj.Pergatit aktet qe jane kompetence te ortakeve te shoqerise.Merret me organizimin dhe drejtimin e shoqerise si dhe percakton strukturen, numrin,kualifikimin e punonjesve te shoqerise, perfaqeson shoqerine ne lidhjen e kontratave dhe kryen veprime te tjera juridike qe nuk jane kompetence te ortakut te vetem.

### Neni 22

Ne mungese apo ne pamundesi te ushtrimit te funksionit te administratorit ate e zevendeson nje punonjes tjetër, qe caktohet nga ai vete me shkrim.

## VI.-MENYRA DHE KUSHTET E PERDORIMIT TE FITIMIT.

### Neni 23

Pas perballimit te detyrave qe ka shoqeria, taksave, tatimeve, pagave te punonjesve dhe shpenzimeve te tjera, fitimi neto i shoqerise qe i perket ortakeve te saj, mund ta perdorin ate lirisht sipas deshires se vet.

## VII.-MARREDHENIET E PUNES DHE PERGJEGJESIA.

### Neni 24

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me Aktin e Themelimit, me kete Statut dhe Kodin e Punes te Republikes se Shqiperise. Shoqeria lidh kontraten per marrjen ne pune te punonjesve sipas Kodit te Punes.

### Neni 25

Punonjesi ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen me profesionalizem dhe disipline te punes. Ortaket, administratori dhe punonjesit e shoqerise jane te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, informacionit, njohurive e perveses se fituar e shkëmbyer ne kuadrin e shoqerise, fshehtesine e gjendjes financiare dhe burimeve te mallrave,identitetin e shumave e te ardhurave te saj, depozitave, te dhena te tjera qe organizimin e orientimin e shoqerise i konsideron sekrete te punes. Te dhenat e punes qe paraqesin sekretet e punes mund te behen te njohura peronave te tjere me lejen e administratorit te shoqerise. Detyrimi per ruajtjen e sekretit vazhdon edhe pas nderprerjes se marrdhenieve te punes me shoqerine.

## VIII.-MBYLLJA E SHOQERISE.

### Neni 26

Ne qofte se humbjet e shoqerise nuk mund te perballohen me mjetet e ortakeve te kesaj shoqerise, te vena me rastin e themelimit te shoqerise, hapet procedura e likujdimit te shoqerise.

### Neni 27

Shoqeria mund te shperndahet me likujdimin e saj. Ne rastin e likujdimit te shoqerise, emertimi i saj do te pasohet nga shenimi "Shoqeria ne likujdim e siper". Ne rast shperndarje te shoqerise, administratori vendos per menyren e likujdimit, ortaket caktojne nje ose disa likujdator, te cilet bejne kujdes qe shoqeria te likujdoje detyrimet, qe ka ndaj personave te trete.

### Neni 28

Kur shoqeria pushon aktivitetin e saj, pasi shlyen detyrimet qe ka, pjesa e mbetur e kapitalit dhe te ardhurat i mbeten ortakeve te saj.

### Neni 29

Veprimtaria ekonomike e financiare e shoqerise mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti. Bilanci vjetor i shoqerise duhet te shqyrtohet dhe miratohet brenda muajit Mars te vitit pasardhes.

### Neni 30

Ne rast vdekje te ortakeve, pasuria e tyre i kalon ne pronesi trashegimtareve ligjor ne perputhje me dispozitat ligjore per trashegimine. Administratori i shoqerise ka te drejte te emeruje avokat dhe ekonomist si dhe t'ju japi te drejta personave te tjere, qe veprojne ne emer dhe per llogari te tij sipas ligjeve ne fuqi.

## IX.-DISPOZITAT E FUNDIT.

### Neni 31

Shoqeria deklarohet e krijuar me vendimin e Ortakeve te shoqerise. Nga kjo dite fiton statusin e Personit Juridik.

### Neni 32

Ndryshimet ne kete statut behen ne te njeten menyre e procedure me te cilen nxirret ky statut duhe zbatuar dispozitat ligjore perkatese.

### Neni 33

Mosmarreshjet ne shoqeri do te zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet do te zgjidhen prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor te qytetit ku i takon.

### Neni 34

Ky Statut u perpilua ne pese kopje per tu administruar sipas ligjit.

## **ORTAKET THEMELUES**

**Besjan Shahini**

Besjan Shahini  
